

---

## SHËNIM METODOLOGJIK PËR PËRMBLEDHJEN PULSI PUBLIK XVIII

---

Mbledhja e të dhënave dhe raportimi i paanshëm dhe i saktë janë gurthemeli i Përmbledhjeve të Pulsit Publik dhe Analizave të Pulsit Publik. Të dhënat grumbullohen përmes metodologjisë të caktuar e cila është përdorur që nga viti 2002 kur UNDP publikoi raportin e parë të Paralajmërimit të Hershëm, paraardhës i Pulsit Publik. Këto anketa të opinioneve bëhen dy herë në vit dhe të dhënat i paraqiten publikut në formën e Pulsit Publik. Pikëpamjet e shprehura në Pulsin Publik janë ato të të anketuarve në një moment specifik kohor. Mostra përfaqësuese e qytetarëve të Kosovës për Pulsin Publik XVIII është përbërë nga 1,306 individë mbi moshën 18 vjeçare të zgjedhur rastësisht, të cilët janë pyetur në lidhje me pikëpamjet e tyre për një sërë çështjesh të bazuara në një pyetësor standard i cili është në përdorim që nga viti 2010. Mostra përfshin një shpërndarje përfaqësuese të burrave dhe grave nga të gjitha komunat e Kosovës që mbulojnë zonat urbane dhe rurale. Anketa e Pulsit Publik XVIII filloi më 27 mars dhe përfundoi më 15 prill 2020. Në përputhje me masat parandaluese për COVID-19 dhe në interes të mbrojtjes të shëndetit të njerëzve, anketa nuk mund të zhvillohej ballë për ballë por u bë përmes intervistave telefonike. Të intervistuarit u zgjedhën përmes Random Dialing Digit (RDD) – një metode e zgjedhjes së rastësishme të numrave të telefonit përmes një sistemi të specializuar ASKIA për Intervistimin Telefonik të Asistuar nga Kompjuteri (Computer Assisted Telephone Interview) e përdorur për programimin e pyetësorëve. Pas rishikimit të pyetësorëve dhe informatave nga testimi, pyetësori është koduar në programin ASKIA FACE. Ky sistem ofron përparësi të shumta për pyetësor të anketave, përfshirë gjeo-etiketimin, zbatimin e modeleve të pyetjeve, ekzekutimin vizual, kohëzgjatjen e anketës, menaxhimin nga larg të intervistuesit dhe ndryshimin / modifikimin e mostrës, si dhe sinkronizimin nga largësia me anketën qendrore. Sistemi siguron një menaxhim të integruar dhe mbikqyr të gjitha detyrat e anketimit në një mjedis të vetëm. RDD përdoret gjerësisht për anketat statistikore.

Për hir të transparencës dhe informimit të saktë UNDP në Kosovë ndan këto fakte kryesore në lidhje me Përmbledhjen e Pulsit Publik:

### **Si është zgjedhur mostra?**

Anketat e Pulsit Publik përdorin metodologjinë sasiore të hulumtimit dhe zbatohen në të gjitha (38) komunat e Kosovës duke përdorur metodën e shkallëzimit të rastësishëm shumëfazor. Mostra përfaqëson ekonominë familjare të Kosovës dhe përfshin burra dhe gra nga të gjitha komunat e Kosovës duke mbuluar zonat urbane dhe rurale. Në mënyrë të veçantë, mostra për Pulsin Publik XVIII përfshiu 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 anëtarë të komunitetëve të tjera të Kosovës (Ashkali të Kosovës, Boshnjakë të Kosovës, Egjiptianë të Kosovës, Goran të Kosovës, Rom të Kosovës dhe Turq të Kosovës).

### **Si sigurohet që mostra përfaqëon popullatën e Kosovës?**

Shpërndarja e mostrave të intervistave bazohet në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të adaptuara për komunitetin serb që nuk morën pjesë në Regjistrimin e Popullsisë në vitin 2011. Anketat e Pulsit Publik e shtojnë numrin e të anketuarve nga komunitetet jo-shumicë për të mundësuar ndarjen e të dhënave sipas përkatësisë etnike.

Kur llogaritet numri i përgjithshëm, të dhënat peshohen duke u bazuar në numrat e vërtetë të popullsisë. Pulsit Publik ka llogaritur që duhet shtuar edhe 34,000 serbë të Kosovës (numrit prej 37.625 K-serbëve sa mendohet që është popullata në 4 komunat veriore<sup>1</sup>) duke sjellë numrin e përgjithshëm të serbëve të Kosovës për qëllimet e këtij studimi në 59,532. Kjo gjithashtu rrit numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës në 1,773,825. Kur merren parasysh këto ndryshime, pesha në anketat e Pulsit Publik zbatohet si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Anëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (Ashkali të Kosovës, Boshnjakë të Kosovës, Egjiptianë të Kosovës, Gorantë Kosovës, Rom të Kosovës dhe Turq të Kosovës): 4%

[Për përshkrimin e plotë të metodologjisë, ju lutemi referohuni Përmbledhjes së Pulsit Publik XVIII: \[https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democrat\\\_governance/public-pulse-xviii.html\]\(https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democrat\_governance/public-pulse-xviii.html\)](https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democrat_governance/public-pulse-xviii.html)

### **Sa të besueshëm janë rezultatet?**

Statistikisht margjina e pranuar e gabimit për anketat është 3%. Margjina për një mostër totale prej 1,306 intervistash për anketën e Pulsit Publik në Kosovë është  $\pm 2.71\%$ . UNDP aplikon kontrolle rigorozë në të gjitha anketat e opinionëve si kërkesë standarde dhe pjesë e sigurimit të cilësisë. Intervistat e kontrollit (back-check) bazohen në kohezgjatjen e intervistave që janë të regjistruara në programin CATI. Kjo qasje është e saktë pasi që informatat merren drejtpërdrejt nga sistemi kështu që ky është një faktor i cili nuk mund të ngatërrohet.

### **A është hera e parë që PP u zhvillua me telefon?**

Përhapja e COVID-19 në Kosovë dhe masat e mëpasshme parandaluese e bënë të pamundur kryerjen e anketave përmes intervistave ballë për ballë. Random Digit Dial është identifikuar si alternativa më e mirë e mundshme dhe një metodë e vlefshme e anketimit.

Për ta realizuar këtë mbledhje të të dhënave sipas standardeve të përcaktuara të cilësisë dhe të arrihet tek numri prej 1,306 intervistave të përfunduara, si mostër përfaqësuese e kosovarëve që jetojnë në Kosovë, u kontaktuan 1.642 qytetarë përmes thirrjeve telefonike. 79.5% e personave të

---

<sup>1</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/2129/estimation-of-kosovo-population-2011.pdf>

kontaktuar ranë dakord të intervistohen për anketë që korrespondon me numrin e përgjithshëm të 1.306 të të intervistuarve.

### **A është e mundur që intervistat telefonike të prodhojnë rezultate të ndryshme nga intervistat ballë për ballë?**

Random Digit Dial bazohet në një softuer të specializuar dhe të sofistikuar, i cili përdoret në të tërë botën. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë sipas metodologjisë të caktuar për anketën e opinionit për Pulsin Publikë për sa i përket gjinisë, rajonit, përkatësisë etnike dhe moshës. Pyetjet e përdorura gjatë anketës telefonike ishin të njëjta me ato të përdorura gjatë intervistave ballë për ballë. Ekipi i punës në terren përbëhej nga 22 intervistues, 3 mbikëqyrës (2 shqiptarë dhe 1 serb), një kontrollues teknik dhe një koordinator.

Secili intervistues përdori një tablet elektronik që funksionon me sistemin Android. Tableti është i lidhur drejtpërdrejt me sistemin e anketimit dhe në thelb është pjesë përbërëse e ASKIA. Lidhja mes tableteve dhe softuerit mundëson identifikimin e çdo pajisje individuale. Në këtë mënyrë, mbikëqyrja e punës të intervistuesit është e standardizuar dhe pa gabime.

### **A janë pyetjet e njejta në 10 vitet e fundit?**

Pyetjet e Përmbledhjes së Pulsit Publik, të cilat përdoren për të identifikuar kënaqshmërinë e qytetarëve me institucionet dhe udhëheqësit kryesorë të Kosovës, janë të njëjta në çdo anketë. Në këtë anketë, për shkak të pandemisë, u shtuan pyetje në lidhje me COVID-19. Ne i ftojmë të gjithë t'i kontrollojnë trendet dhe grupet e të dhënave në Vizualizuesin e Pulsit Publik. Të dhënat në këtë Vizualizues datojnë që nga nëntori 2010 dhe mund të gjenden përmes vegëzës vijuese <http://unckt.org/public-pulse/>

Të dhënat ndahen sipas gjinisë, rajonit, përkatësisë etnike dhe moshës.

### **Qe sa kohë i zhvillon UBO Consulting këto anketa?**

UBO Consulting u zgjodh përmes një procesi të hapur dhe konkurrues për të kryer anketa të Pulsit Publik. Që nga viti 2015, UBO Consulting ka realizuar gjashtë anketa për Përmbledhjen e Pulsit Publik dhe dy hulumtime të tjera që poashtu lidhen me publikime të Pulsit Publik. UBO Consulting ka kryer edhe hulumtime të tjera, në fusha tjera, për UNDP në Kosovë.